

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “[S...]” sh.a., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S2..]”, me seli në Prishtinë, për shkak të rimbursimit të borxhit, vlera e kontestit 4,862.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.439/2015, të datës 31.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S2..]”, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.439/2015, i datës 31.10.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në paragrafin I të dispozitivit, e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “[S...]” me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet i padituri Kompania e Sigurimeve “[S2..]” me seli në Prishtinë, që paditësit ne emër të rimbursimit të borxhit, t’ia paguaj 4,191.38 €, me kamatë prej 12% në vit, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë data 30.09.2015, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit së këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit t’ia paguaj shumën prej 280.00€, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “[S2..]” me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoje ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t’ia kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paditësi Kompania e Sigurimeve “[S...]”, me seli në Prishtinë, me datën 30.09.2015, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S2..]”, me seli në Prishtinë, për shkak të rimbursimit të borxhit, në vlerë prej 4,862.00 €, lidhur me aksidentin e datës 31.10.2014, në mes të automjetit Audi, me targa regjistrimit [...], i siguruar tek e paditura

dhe automjetit Toyota, me targa të regjistrimit Police-[...], pronë e Policisë së Kosovës, i siguruar te paditësi, i cili ka qenë i dëmtuari në aksidentin e lartëcekur. Pasi që dëmi i shkaktuar është kompensuar nga paditësi, në bazë të kontratës që kishte lidhur paditësi me Policinë e Kosovës për kompensimin dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara në automjetet e Policisë së Kosovës, ai ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të detyroj të paditurën që në emër të rimbursimit të borxhit t'ia paguaj këtë shumë.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar së ne mes palëve ndërgjyqës me datën 31.10.2014 në Suhareke, tek Ura e Sopisë ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku te përfshira kanë qenë automjeti i tipit "Audi", me targa të regjistrimit [...] dhe vetura "Toyota" me targa të regjistrimit Police-[...], pronë e Policisë së Kosovës. Pasi që automjeti "Toyota" i siguruar te paditësi, me targa të regjistrimit Police-[...], pronë e Policisë së Kosovës, kishte pësuar dëme materiale për të cilat paditësi Kompania e Sigurimeve "[S...]" mbi bazën e kontratës së lidhur mes Policisë së Kosovës dhe Kompanisë së Sigurimeve "[S...]", i ka kompensuar dëmet e shkaktuara në lartësia prej 4,862.00 €, me të drejtë ka parashtruar kërkesën e rimbursimit të borxhit pranë kompanisë siguruese "[S2..]", në të cilën ishte siguruar automjeti i cili ishte shkaktari kryesor i aksidentit të trafikut të datës 31.10.2014. Gjykata e shkallës së para ka theksuar së ne mes palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese fakti se automjeti "Toyota", ka pësuar dëme materiale në aksidentin e komunikacionit. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se automjeti i tipit "Audi", ne momentin e aksidentin posedonte Policë valide të sigurimit nga auto përgjegjësia, të lëshuar nga i padituri. Eksperti i komunikacionit ka dhënë mendimin se shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit "Audi". Ndërsa në ekspertizën e makinerisë ka dhënë mendimin se vlera e dëmit të pësuar në automjetin e dëmtuar në aksidentin e komunikacionit është në shumën prej 4,191,38€.

Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në ekspertizën e komunikacionit të datës 02.10.2017, të punuar nga eksperti Skënder Shala, sipas të cilit shkak i aksidentit janë lëshimet e drejtuesit të automjetit "Audi", i cili ka zhvilluar shpejtësi të madhe rreth 130km/h dhe të papërshtatshme për kushtet e rrugës me kthesa, i njëjti ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, ashtu që me te hyrë në kthesë në anën e majtë të tij e humbë kontrollin mbi automjetin, duke u përplasur në mbrojtësit anësor të rrugës, dhe së fundi e godet automjetin "Toyota" që ishte në përball-kalim. Ndërsa për lartësinë e dëmit gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit për vlerësimin e dëmit Skënder Shala, të dhënë në ekspertizën teknike të datës 03.10.2017, sipas të cilit konstatim vlera reale e kompensimit të dëmit të pësuar nga i siguruari i paditësit respektivisht kostoja e riparimit të automjetit të dëmtuar kap shumën prej 4,191.38€. Andaj gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat n) dhe o) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore

dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në bazë të kontratës së lidhur me SHPK, me datë 29.09.2011, ka bërë kompensimin e dëmeve dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguarit kanë kaluar te paditësi kjo duke u bazuar edhe në dispozitat e nenit 939 të LMD-së me të cilën është përcaktuar se *"Me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguresin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi"*. Poashtu drejtë është aplikuar edhe dispozita e nenit 25 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia me të cilin është përcaktuar se : *"I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësive t'ia parashtojë drejtpërdrejt siguresit përgjegjës. Siguresi është i detyruar që ditën e pranimit ta regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim në librin/evidencën e posaçme të dëmeve sipas radhitjes numerike dhe në afat prej tre (3) ditësh, ta vërtetojë pranimin duke njoftuar palën me referencën e kërkesës së evidentuar"*.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet ankimore lidhur me caktimin e kamatës, por gjeti se janë të pabazuara sepse me dispozitat e nenit 277 të LMD-së lidhur me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Nr. 04/ L-018 (i vitit 2011)parashihet kamata në lartësi prej 12%, në vit e cila llogaritet për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguresi. Nga shkresat e lëndës del se paditësit me datë 30.09.2015 ka paraqitur padi, nga e cila datë i është bërë edhe llogaritja e kamatës, andaj Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia ka qenë në fuqi në kohën e llogaritjes së kamatës ligjore.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.287/2017, dt.20.03.2019

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutull, d.y.

